



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 30.04.2019, ora 10:00

Drejtton mbledhjen:

Milva Ekonomi- nënkryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbaleve të datave 8, 9, 11, 15 dhe 16 prill 2019.
2. Seancë dëgjimore me ministren e Kulturës në lidhje me zbatimin e legjislacionit për trashëgiminë kulturore dhe muzetë në qytetin e Gjirokastrës.

Marrin pjesë:

Milva Ekonomi, Fidel Ylli, Musa Ulqini, Vilma Bello, Ismet Beqiraj, Adelina Rista, Bujar Çela, Almira Xhembulla, Lindita Nikolla, Mirela Kumbaro.

Mungojnë:

Fadil Nasufi, Enada Kapllani.

Të ftuar:

Elva Margariti – Ministre e Kulturës,

Enida Xhumari – drejtore Kabineti në Ministrinë e Kulturës,

Risena Xhaja – sekretare e Përgjithshme e Ministrisë së Kulturës,

Arta Dollani – drejtore e Përgjithshme e Institutit të Monumenteve të Kulturës,

Sofjan Jaupaj – drejtor i të Drejtave të Autorit,

Kozeta Angjeliu – drejtore e Programeve të Zhvillimit të Kulturës,

Alma Mile – këshilltare e Ministres së Kulturës.

HAPET MBLEDHJA

Milva Ekonomi – Mirëmëngjesi të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e radhës së Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik. Sot në rendin e ditës kemi miratimin e procesverbaleve të datave 8, 9, 11, 15, 16 prill 2019. Unë nuk e di nëse ju, kolegë të nderuar, i keni lexuar procesverbalet dhe keni pasur mundësi të bëni komente. Unë personalisht i kam lexuar dhe kam bërë komente, të cilat ia kam depozituar Arianës. Nuk e di nëse ju keni shtuar diçka, por, nëse keni sugjerime, ju lutem, brenda ditës së sotme të kaloni sugjerimet e bëra tek Ariana.

Pika e dytë e rendit të ditës është seancë dëgjimore me ministren e Kulturës, zonjën Elva Margariti, në lidhje me zbatimin e legjislacionit për trashëgiminë kulturore dhe muzetë në qytetin e Gjirokastrës.

Së pari, dua t’ju falënderoj, zonja Elva, që pranuat të vini sot në komision. Unë e di që kjo është detyra juaj, por pranuat duke e marrë me entuziazëm dhe duke thënë që kjo është një detyrë që na takon dhe duhet të flasim edhe për çështjet që shqetësojnë publikun.

Së dyti, dua t’ju falënderoj edhe për informacionin shterues që na keni dorëzuar në datën 26 të këtij muaji, që komisioni e ka marrë dhe është vënë në dijeni të të gjitha informacioneve që ju keni sjellë.

Zoti Ylli mund të më ndihmojë nëse kuorumi është plotësuar për të filluar mbledhjen. Shoh që pjesa më e madhe e kolegëve janë ulur, por dua konfirmimin e zotit Ylli.

Fidel Ylli - Kuorumi është i plotë, ne mund të vazhdojmë mbledhjen, megjithëse do të doja që anëtari i opozitës të ishte i pranishëm. Nuk e di nëse ka sjellë ndonjë justifikim për mungesën e tij, sepse ata që do të marrin pjesë në komisione, u miratuan në parlament.

Milva Ekonomi – Nga informacionet që unë kam, nga ndjekja që ka bërë sekretaria, anëtari i opozitës ka një situatë shëndetësore disi të vështirë, prandaj nuk është prezent sot në mbledhje.

Faleminderit për kujtesën!

Zonja Ministre, ne kemi punuar shumë me ligjin “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë” dhe e dimë që është një punë e mirë e bërë nga Ministria e Kulturës, e mbështetur edhe nga shumë donatorë dhe ishin dëgjuar shumë grupe interesi kur filloi të hartohej ky projektligj, derisa u shndërrua në ligj. Punët në komision kanë qenë disajavore. Ne e dimë që ligji që hartuam i shërbente shumë mirë punës në të ardhmen për trashëgiminë kulturore dhe krijimit

të mundësive për financimin e veprimtarive në *sitet* e trashëgimisë kulturore. Ndërkohë, në media ne kemi dëgjuar shpeshherë shqetësimin për situatën në Gjirokastrë dhe duam të na vini në dijeni lidhur me projektin që po zbatohet në Gjirokastrë, në pjesën e vjetër të qytetit.

Zonja Elva, fjala për ju.

Elva Margariti – Faleminderit, ju!

E nderuar nënkryetare,

Të nderuar deputetë, anëtarë të këtij komisioni,

Është e vërtetë që ligji nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë” përfaqësoi konkluzionin e një procesi të gjatë legjislativ, të cilin unë e kam ndjekur jashtë këtyre mureve dhe për të gjithë ne ka qenë një proces, i cili kishte nevojë që të ndiqej, sepse ishte i gjatë, por që tashmë ka hyrë në një rrugëtim, i cili është i nevojshëm të zbatohet në terren me pika dhe hapa konkretë.

Risi e këtij ligji është fakti që ka një gjithëpërfshirje, jo vetëm nga ekspertë të ndryshëm të trashëgimisë kulturore, por edhe të së drejtës. Ky është një ligj që bazohet edhe në karakteristikat e peizazhit dhe të urbanistikës dhe ka vlerësuar që sfida të jetë që çdo pjesë e trashëgimisë kulturore, të futet në një kontekst historik dhe, mbi të gjitha, çdo element i tij të kthehet në një motor zhvillimi ekonomik. Besoj se kjo është hera e parë që flitet për trashëgiminë kulturore jo vetëm në kuadrin e konservimit dhe të ruajtjes, por, për më tepër, në rikualifikimin dhe rijetësimin, ku fjala “rijetësim” është elementi kyç, për të cilin jemi mbledhur ne sot. Qëllimi nuk është vetëm ruajtja, mbrojtja, vlerësimi dhe administrimi, por edhe përfshirja e trashëgimisë kulturore muzeale.

Në momentin që flasim për Gjirokastrën, vërtet flasim për një qytet muze në qiell të hapur dhe besoj se nuk ka qytet më kuptimplotë për zbatimin e këtij ligji.

Është e rëndësishme që të flasim për Gjirokastrën, duke filluar nga ruajtja. Në këto vite është bërë shumë për mirëmbajtjen dhe për konservimin. Kuptohet, ka ende shumë për të bërë, sepse po flasim për një qytet të tërë, nuk po flasim për prekje pikësore në qytete ose në fshatra të vegjël. Mbi të gjitha, kjo edhe për vlerën e shtuar që ka Gjirokastra si pasuri botërore e UNESCO-s. Kjo shton edhe më tepër detyrimet tona nëpërmjet kornizimit të ligjit, që të vazhdohet një punë e mirëfilluar, por, mbi të gjitha, shton edhe një përgjegjësi të madhe për vetështrirjen, siç thashë, të të gjithë këtyre vlerave në të gjitha territorin.

Përcaktimi i rregullave, i procedurave, i autoriteteve shtetërore përgjegjëse për ruajtjen, për mbrojtjen, për vlerësimin, për administrimin e pasurive dhe trashëgimisë kulturore është një nga fazat kyçe, në të cilat ndodhemi tashmë, me ngritjen e strukturave të reja për zbatimin e këtij ligji. Risitë janë jo vetëm në prezantimin e nocioneve në fushën e trashëgimisë

kulturore. Për shembull, në nenin 8 flasim për vlerësimin e trashëgimisë kulturore, i cili konsiston në ushtrimin e atyre funksioneve dhe aktiviteteve që kanë si qëllim njohjen, promovimin e pasurisë, si dhe të sigurojnë kushte më të mira për shfrytëzimin publik të pasurive dhe vlerave kulturore.

Pra, parashikimi i formave të reja të administrimit të këtyre pasurive është një nga elementet kyçe të ligjit, me të cilin, me aktet nënligjore që jemi duke përpunuar në këtë moment, do të sjellim vërtet kompletimin dhe fuqizimin e këtij ligji në terren.

Gjatë zbatimit të ligjit nr. 9048/2003 “Për trashëgiminë kulturore” ndër vite, u konstatua se shumë nga dispozitat e këtij ligji nuk arritën objektivat e parashikuar, sidomos në realizimin konkret të bashkëpunimit shtet-privat. Me anë të ligjit të ri këto janë të gjitha elemente, të cilat vërtet kanë filluar të marrin jetë, sepse këto vite bashkëpunimi i shtetit dhe privatit është parë si e vetmja formë suksesi jo vetëm në Gjirokastrë, por në të gjitha *sitet* tona të trashëgimisë kulturore. Nisur nga ky fakt, dua të sqaroj se një ndër risitë e këtij ligji është edhe futja e formave të reja të administrimit të pasurive kulturore, për të cilat procedurat për aplikim, pra rast pas rasti, janë të qarta, janë transparente dhe janë kolegjiale. Këto mënyra administrimi ndahen në administrim të drejtpërdrejtë nga ana e institucioneve të specializuara për trashëgiminë kulturore dhe në administrim indirekt nga entet publike të krijuara nga institucionet e specializuara të trashëgimisë kulturore.

Në vijim të miratimit të ligjit, Ministria e Kulturës është angazhuar me kapacitete të plota, si edhe me ndihmën e Fondit Shqiptaro-Amerikan të Zhvillimit për miratimin në kohë të 102 akteve nënligjore, të cilat janë të listuara në listën që i kemi dërguar sekretarisë së komisionit parlamentar. Konkretisht, qasja për qytetin e Gjirokastrës lidhet ngushtë me krijimin e Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore, me kompetenca të qarta, të orientuara drejt specifikës së pasurisë botërore që ka Gjirokastra. Pra, ndryshe nga drejtoritë rajonale të trashëgimisë kulturore të qyteteve të rajoneve të tjera, në rastin e Gjirokastrës kemi edhe një element të shtuar, që e bën ende edhe më sfidues punën, detyrimet dhe përgjegjësitë e kësaj drejtorie.

Gjithashtu, qasja e ligjit në lidhje me Gjirokastrën lidhet edhe me krijimin e kuadrit rregullator për administrimin indirekt të disa pasurive kulturore në qytetin e Gjirokastrës, ku tashmë sektori privat, mund ta themi me plot gojën, është angazhuar plotësisht në administrimin në mënyrë të qartë, të kontrolluar dhe bashkëveprues në hapësirat në të cilat janë ndërmarrë tashmë hapa konkretë të rehabilitimit dhe rijetësimin.

Krijimi i këtij modeli të qartë ligjor lidhur me rijetësimin e trashëgimisë kulturore, ndalon në mënyrë kategorike të gjitha transformimet e ndodhura në të shkuarën, në pjesën e arkitekturës.

Gjithashtu, organet e reja vendimmarrëse kolegjiale kanë një qasje më europiane në dhënien e lejes dhe dhënien në përdorim për rijetësimin e këtyre shtëpive të famshme, që nuk janë vetëm bujtina, por shtëpi muze, hotele dhe aktivitete të ndryshme ekonomike. Pra, diversifikimi i aktiviteteve ekonomike në rijetësimin e trashëgimisë kulturore është qasja kryesore e ligjit, për të dhënë një formulë sa më të larmishme dhe asnjëherë të lodhshme për turistët ose për personat të cilët vizitojnë Gjirokastrën. Rishikimi i gjithë kuadrit rregullator për sa i përket trashëgimisë kulturore jomateriale, bën që Festivali Folklorik Kombëtar i ardhshëm i Gjirokastrës të aplikojë këtë ligj, për sa i përket trashëgimisë jomateriale.

Dua të ndalem pak këtu, pasi besoj fort se, për sa është bërë deri tani, ndoshta fokusi ka qenë gjithmonë në aspektin e trashëgimisë materiale, tek trashëgimia më e prekshme fizikisht, por vlera reale e këtij ligji do të jetë fuqizimi i gjithë pjesës së trashëgimisë jomateriale, jo vetëm në Gjirokastrë, por edhe në të gjitha vendet e tjera në territor. Tashmë po fillojmë të kemi sensibilizimin e duhur që trashëgimia jomateriale është vërtet hapi drejt krijimit të një identiteti kulturor, që ne, si komb, duhet ta mbajmë lart, duhet ta dokumentojmë, ta vlerësojmë, ta sjellim gjithmonë e më shumë në jetë, t'ua përcjellim brezave të ardhshëm, sepse është ajo për të cilën UNESCO afrohet drejt nesh, duke na kërkuar të bashkëpunojmë me ta, që të kemi sa më tepër mundësi për të treguar vlerat tona.

Faktikisht, së fundi kemi aplikuar me dy dosje të reja në UNESCO për trashëgiminë jomateriale. Mendoj se edhe shumë të tjera do të vazhdojnë të vijnë. Është në fokus të ministrisë ligji, i cili na e jep të drejtën, që nëpërmjet komisioneve të posaçme për trashëgiminë jomateriale, të mund të ngremë praktika të mira dhe të mund të futemi në një rrugëtim të ri drejt UNESCO-s, sepse nuk janë vetëm Berati dhe Gjirokastra pjesë e trashëgimisë materiale.

Siç thashë edhe në fillim, dua të ndalem te të gjitha ndërhyrjet që janë bërë në Gjirokastrë. Mund të themi se kanë qenë vërtet hapa të vështirë, pasi e dimë të gjithë shumë mirë që buxheti i shtetit nuk lejon asnjëherë që të ketë një prekje të mirështrirë në të gjithë territorin. Për këtë ka pasur një bashkëpunim shumë të mirë edhe me donatorët e huaj, një bashkëveprim siç thashë, me Fondin Shqiptaro-Amerikan të Zhvillimit jo vetëm në hartimin e ligjeve, por edhe në donacione. Kemi pasur partnerë të BE-së dhe të Bankës Botërore. Pra, janë krijuar partneritete me të gjitha ekspertizat e ekspertëve dhe të mjeshtëurve në terren. Edhe pse një pjesë e mirë është kryer nëpërmjet këtyre partneriteteve, gjatë vitit 2018, me fonde të buxhetit të shtetit, janë kryer investime në shumën prej 50 milionë e 644 mijë lekë për

restaurimin e kishës së Shën Mërisë në Peshkëpinë e Sipërme, në Gjirokastrë, për restaurimin e kishës së Shën Apostujve në Hoshtevë, në Zagori, për restaurimin e urës së Kollorcës në Lazarat, për restaurimin dhe konsolidimin e urës së Nivanit në Zagori. Njëkohësisht, nëpërmjet institucioneve të specializuara, Drejtorisë Rajonale Kombëtare të Kulturës në Gjirokastrë, që monitorojnë dhe mirëmbajnë monumentet e kulturës, janë kryer punime të vazhdueshme për mirëmbajtjen e objekteve të trashëgimisë kulturore, për mbrojtjen nga dëmtimet, nga degradimi, nga agjentët atmosferikë. Kjo është një punë konstante dhe kjo është periudha kryesore, kur të gjitha drejtoritë rajonale janë të fokusuara në terren për mirëmbajtjen dhe pastrimin e trashëgimisë kulturore.

Faza e pastrimit është nga më të rëndësishmet, pasi është pjesa kur vegjetacionet fillojnë dhe mund të agravohen mbi monumentet. Në vitin 2018 DRKK-ja në Gjirokastrë bashkë me specialistë dhe punëtorë të institucionit, ka kryer mirëmbajtje, pastrime, sistemime në kalanë e Gjirokastrës, ndërhyrje mirëmbajtjeje dhe restauruese në 30 objekte, që kanë qenë kryesisht banesa, por edhe objekte kulturi dhe sistemime, si në Parkun e Antigonesë dhe atë të Adrianopolit. Gjatë vitit 2019 është parashikuar një fond prej 8 milionë lekësh për mirëmbajtjen e rreth 25 objekteve monumentale të kulturës dhe deri tani janë kryer punime mirëmbajtjeje në 6 banesa, në një objekt kulturi, si dhe në kalanë e Gjirokastrës.

Në realizimin e misionit të Ministrisë së Kulturës duhet të themi se bashkëpunimi i frytshëm me donatorët, ka kontribuar shumë për ngritjen edhe të fondeve të tjera, sepse nëpërmjet donatorëve është krijuar edhe një hallkë, zinxhir bashkëpunimi midis donatorëve.

Restaurimi i Qafës së Pazarit ka përfunduar fazën e parë dhe ka konsistuar në restaurimin e 8 blloqeve. Restaurimi total ka qenë rreth 5220 metra katrorë, pra nuk ka qenë aspak sipërfaqe e vogël, duke konsideruar të gjithë shtrirjen e Qafës së Pazarit. Janë restauruar fasada, korniza, janë unifikuar, janë prodhuar qepenat me palosje, është unifikuar e gjithë pjesa e Qafës së Pazarit për t'i dhënë identitetin, i cili tashmë me kohën ishte zaptuar nga dëshira, nevojat dhe nga idetë e secilit prej personave që jetonin në atë hapësirë. Ky projekt është kryer në bashkëpunim me Fondin Amerikano-Shqiptar për Zhvillim. Vlera financiare ka qenë rreth 22 milionë lekë.

Vendosja e biletarisë elektronike në Kalanë e Gjirokastrës ka qenë një tjetër modernizim i shërbimit të ofruar në Gjirokastrë, shërbim i cili shtrihet në disa *site* kulturore. Edhe ky projekt është mbështetur nga Fondi Shqiptar - Amerikan për Zhvillim.

Vazhdon projekti për rehabilitimin e infrastrukturës dhe restaurimin e kalldrëmeve në Pazarin e Gjirokastrës. Ky është një investim i Bankës Botërore, i kryer nëpërmjet Fondit Shqiptar të Zhvillimit. Vlera është rreth 138 milionë lekë. Punimet kanë të bëjnë me

rehabilitimin e infrastrukturës inxhinierike të rrjetit të kanalizimeve, të furnizimit me ujë, me energji elektrike, të telefonisë, të rrjetit LAN, si dhe të gjithë restaurimin e kalldrëmeve, të trotuareve, më pas, në mbarim, të sistemit të gjithë këtyre kanalizimeve. Kjo vjen pas përfundimit të fazës së parë, siç thamë, të të gjithë restaurimit të fasadave dhe unifikimit të të gjithë Qafës së Pazarit.

Është e vërtetë që ka sjellë shumë debat një ndërhyrje e tillë, por është po aq e vërtetë se në vitin 2019 këto shërbime në Gjirokastrë, e cila shikon tek trashëgimia kulturore një motor zhvillimi, ishin mëse të nevojshme, sepse nuk mund të flasim për asnjë lloj funksioni vital, që mund të kenë këto aktivitete, pa rrjetin minimal bazik të nevojshëm për të kryer jetesën e përditshme.

Është e vërtetë që është një proces, i cili mund të sjellë, për një periudhë kohore gjatë kryerjes së punimeve, disa disavantazhe në aksesimin e këtyre aktiviteteve. Unë isha vetë në Gjirokastrë dhe i ndoqa nga afër si punimet, po ashtu u takova edhe me banorët, me pronarët e aktiviteteve. Janë të gjithë të sensibilizuar dhe të bindur se kjo është një e mirë e përbashkët, një investim i nevojshëm, që me siguri mund të ishte kryer shumë kohë më parë dhe sot duhet të ishim në kushtet më optimale të përfundimit të gjithë rijetëzimit të Pazarit, por nuk është asgjë tjetër përveç polemikave se “sa shpejt do të mbarojnë këto punime?”. Pra, nuk ka absolutisht asnjë aspekt teknik, për mendimin tim, për t’u shqetësuar, përtej të gjithë polemikave për vendosjen e kalldrëmeve, për vendosjen e kanalizimeve. Jetojmë në një kohë ku tashmë të gjithë duket sikur nëpërmjet internetit ose faqeve në *Facebook*, kthehen në ekspertë të menjëhershëm të çdo fushe profesionale të profesionistëve të tjerë. Jam e bindur se shumë shpejt me hapat e rregullta që po ndjekim, jemi plotësisht në kohë me kantierin. Nuk ka absolutisht asnjë vonesë në të gjitha punimet dhe pse janë kryer disa modifikime gjatë rrugës, sepse të tilla janë rijetëzimet, rikualifikimet dhe restaurimet. Gjithmonë ka të papritura dhe gjithmonë do të ketë ndryshime gjatë kantierit edhe të pjesëve të projektit. Jemi totalisht në kohë dhe jam besimplotë se gjithçka do të përfundojë mirë në momentin e duhur.

Milva Ekonomi – Faleminderit, zonja Margariti!

Kolegë, keni ndonjë pyetje?

Unë vetë kam renditur disa pyetje, por nëse ka pyetje edhe nga ju, do të ishte mirë.

Fidel Ylli – Unë kisha një pyetje. Ne, si komision, vajtëm në një vizitë në kalanë e Gjirokastrës e në Butrint. Të them të drejtën na pëlqeu atmosfera atje, ndryshimet, të ardhurat nga biletat elektronike etj., por qytetarët aty kishin një shqetësim për sa i përket punimeve, të cilat po zgjasnin pa fund dhe kjo po u prishte punë në biznesin e tyre.

Nuk e di si është situata aktuale, por në atë periudhë, situata ishte: ndërtohej, pluhuri përhapej nëpër të gjitha aktivitetet atje. Do të duhej që firma të punonte më shpejt, të mbaronte punë më shpejt, që të paktën periudha e verës t'i gjente të përfunduara gjitha ato rrugicat.

Shqetësimi tjetër është se, për mendimin tim, nuk do të ketë asnjë vlerë gjithë ai investim, në qoftë se Gjirokastrës nuk do t'i bëhet një unazë, me qëllim që makinat të mos kalojnë në Qafën e Pazarit e në rrugët me kalldrëm.

Faleminderit!

Bujar Çela – Përshëndetje, Ministre!

Shpjegimi juaj ishte shterues. Mendoj se Ministria e Kulturës ka pas bërë punë, dhe ju jeni pikërisht për vazhdimësinë e asaj që është bërë.

Në vijim të fjalës së kolegut Ylli, kemi parë disa vepra muzeale e prehistorike, por ajo që më ka rënë në sy në Gjirokastrë, është dypronësia brenda një ndërtese. Nuk e di si e sheh këtë çështje ministria, në lidhje me trajtimin si pjesë e bashkisë, si pjesë e ministrisë. Nuk e di sa jam i qartë.

Nëse kryetarja më lejon të dal pak nga rendi i ditës, që të mos e ripërsëris, në janarin e 2020-ës është 100-vjetori i Kongresit të Lushnjës. Nuk e di nëse ministria ka ndonjë projekt, megjithëse ajo është ende pronë private. E dyta, muzeu historik, i cili ndodhet pikërisht në qendër të Lushnjës, ka disa muaj që është shkarravitur, i janë marrë pllakat e mermerit dhe është kthyer në kantier, pa qenë kantier.

Faleminderit!

Milva Ekonomi – Faleminderit!

Ndokush tjetër? Po, Ismet.

Ismet Beqiraj – Përshëndetje!

Kam nja dy pyetje. Një pjesë e fshatrave që kanë marrë statusin për rilindjen rurale, kanë vepra të trashëgimisë kulturore, kanë edhe asete arkeologjike. Më konkretisht, fjalën e kam për Bylisin. Ju jeni marrë edhe me këto projekte. Ministria e Kulturës, për rijetëzimin, rivitalizimin e këtyre pasurive, për t'i kthyer edhe në një atraksion për turizmin arkeologjik e historik në zona të veçanta, a ka ndonjë projekt të veçantë? Sidomos e kam fjalën për Bylisin. Fshati Hekal është në toplotën e dhjetë fshatrave që përfitojnë nga programi i rilindjes rurale. Kjo është pyetja e parë.

Pyetja e dytë: Ky vit është 75-vjetori i çlirimit të atdheut. Ndër veprat e trashëgimisë kulturore dhe historike janë edhe veprat që kanë të bëjnë me heronjtë: varrezat e dëshmorëve, muzetë e asaj epopeje të lavdishme të popullit shqiptar. A e ka Ministria e Kulturës në projektet e saj organizimin në mënyrë sa më dinjitoze të këtij festimi?

(Ndërprerje e shkurtër incizimi.)

Milva Ekonomi – ...për Ministrinë e Kulturës.

Ka pyetje ndokush tjetër?

Tani, në ligjin për “Trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, natyrisht që ne kemi diskutuar edhe në lidhje me peizazhin. E thatë edhe ju, zonja Ministre, po për Gjirokastrën, e cila ofron edhe një peizazh, përveçse monumenteve të kulturës, a kemi marrë ndonjë masë për mbrojtjen e peizazhit të Gjirokastrës?

Ne kemi dëgjuar shumë shpesh për rijetësimin e shtëpive gjirokastrite. A kanë njohuri të plotë pronarët e shtëpive gjirokastrite se si veprohet në këtë rast? A e dinë ata se cilat janë të drejtat dhe detyrimet që kanë, kur marrin një shtëpi të këtij lloji? A i keni vënë në dijeni ata për këto pasuri që kanë në përdorim ose posedojnë?

Unë isha dje për një vizitë personale në Gjirokastrë dhe pashë punimet që po bëheshin në pazarin e Gjirokastrës. Pata rastin të takoj qytetarë të Gjirokastrës, të cilët në përgjithësi mendonin që ishte një investim i duhur, por kishte një shqetësim nga ata lidhur me fluksin e turistëve, të cilët kanë nevojë të kenë disa *infopoint-e* për të lëvizur në qytetin e Gjirokastrës. Si mund të hyhet për të parë disa nga pasuritë e qytetit, sepse rruga ishte e bllokuar? A ka menduar ministria për të dhënë një ndihmë në bashki ose për të ndërmarrë vetë ndonjë aksion për mënyrën e orientimit të turistëve në qytetin e Gjirokastrës?

Ne, në fakt, disa herë në këtë komision, kemi zhvilluar edhe takime lidhur me monumentet e trashëgimisë kulturore që janë në rrezik dhe Ministria e Kulturës ka hartuar ose mban të gjallë një listë të monumenteve të kulturës që janë në rrezik. A është shtuar apo është pakësuar kjo listë? Si është situata e monumenteve në rrezik?

Edhe zoti Ismet e ngriti që ka një shqetësim për restaurimet që po ndodhin në kuadrin e programit të “100 fshatrave”. A keni ndonjë informacion shtesë për të na dhënë?

Dua të shtoj një informacion, që në kuadrin e kontrollit parlamentar, komisioni ynë ka ndërmarrë disa udhëtime nëpërmjet mbështetjeve të ndryshme, që na vijnë nga donatorë ose edhe nëpërmjet diskutimeve që bëjmë me OSBE-në, në kuadrin e mbështetjes që ajo i bën parlamentit Shqiptar, për të parë nga afër se si është situata e *site-ve* dhe pyetjet që erdhën nga ne vijnë si pyetje direkte, sepse ne kemi vizituar Butrintin, Gjirokastrën, Apoloninë, Krujën, Beratit, Korçën, kemi parë edhe muzeun e Durrësit, pra kemi qenë në disa *site* të trashëgimisë kulturore, se ne e ndjekim veprimtarinë që harton, drejton apo nxit Ministria e Kulturës, prandaj kemi pyetje, herë pas here, që i drejtojmë te ju, për të parë se si mund të zgjidhen problematikat.

Një nga pyetjet që na është drejtuar neve, si komision, ka qenë për strukturën e pagave të punonjësve të këtyre muzeve, nëpër *site-t* ku kemi shkuar dhe i kemi takuar. A ka ndonjë

risi këtë vit lidhur me strukturën e pagave të këtyre punonjësve, duke pasur parasysh se ato kanë të ardhura dytësore, që vijnë nga shitja e biletave, falë biletarisë elektronike që ju keni vënë? A ka ndonjë mënyrë se si mund të shpërndahen benefite për pagë? Si keni menduar ju për të ardhurat dytësore që të shkojnë në investime të vogla brenda *site*-ve, si për dezinfektantë ose gjëra të tjera të kësaj natyre?

Kam edhe një pyetje për një letër që i është drejtuar komisionit tonë, por ju ka ardhur edhe juve nga shoqata “Tirana”, për një muze që ata mendojnë se duhet të ngrihet në qytetin e Tiranës. Nuk e di nëse keni një përgjigje për shoqatën, se do të ishim të interesuar të kishim edhe ne një kopjo të përgjigjes.

Faleminderit!

Elva Margariti – Po filloj nga shqetësimi kryesor, për pjesën e kalldrëmeve në vijim të të gjitha punimeve të kanalizimeve në Qafën e Pazarit.

E thashë edhe gjatë fjalës sime se jemi totalisht brenda afateve dhe absolutisht nuk ka dalë asnjë moment nga parashikimi, sepse të gjitha këto parashikohen që në hartimin e projektit dhe të kohëve të projektit. Në momentin që flasim për restaurime, gjithmonë jemi më komod në momentin që paraqesim kalendarin e punimeve, sepse është gjithmonë e parashikuar që kohët mund të kenë zgjatur për shkak të të papriturave që mund të ndeshen gjatë punimeve.

Punimet kanë filluar me një proces të gjatë dhe shumë delikat, me lëvizjen e të gjitha pjesëve të kalldrëmeve në sektorë të dedikuar, të gjitha të numëruara, të ndara me lote dhe të dokumentuara, si në aspektin fotografik, me dron, ashtu edhe me vizatime.

Kjo do të sjellë një proces të gjatë në rivendosjen e kalldrëmeve pas përfundimit të plotë të të gjithë pjesës së kanalizimeve. Ky është një proces, që, për banorët dhe vetë administratorët e aktiviteteve buzë Qafës së Pazarit, mund të duket i gjatë, por është e nevojshme të kryhet me atë ritëm dhe me ato modalitete. Në asnjë moment nuk duhet të biem pre e nevojës për të ecur më shpejt.

Po punohet me mjeshtërit e duhur. Janë rreth 16 mjeshtër skalitës guri. Ky është një tjetër aspekt shumë i rëndësishëm, që duhet theksuar, sepse mjeshtëria dhe profesionalizimi i shtrimit me kalldrëm është një nga elementet kyçe, që duhet të respektohet. Ata kanë ndihmësit e tyre. Ky është edhe si një kantier, si një shkollë e hapur në terren. Po ashtu, kjo është një vlerë e shtuar edhe për komunitetin e ri të ustallarëve, të cilët mund të formohen pak e nga pak, duke ndihmuar mjeshtërit në terren.

Siç e thashë, nuk jam e shqetësuar për efektin e kohës. Ndoshta në disa pika duhet të informojmë akoma dhe më tepër banorët se cila është ecuria kohore. Ndoshta kjo nuk ka qenë

e pasqyruar në ndonjë ambient të posaçëm. Këtë e shikoj si zgjidhje të shqetësimit të tyre konstant.

Unë isha për vizitë në Gjirokastrë. Turistët vazhdonin ta frekuentonin Qafën e Pazarit, edhe pse kishte punime. Madje, shumë prej tyre ndalonin për të ndjekur mjeshtërinë e skalitjes dhe rivënies së gurëve të kalldrëmit.

Nuk duhet të shikojmë çdo gjë me kaq negativitet. Me sa vura re, turistët e huaj qëndronin më gjatë, sepse shikonin një dukuri, që në vendet e tyre nuk e kanë ndeshur. Kishte shumë turistë që bënin fotografi dhe ndërvepronin me mjeshtërit.

Për sa i përket planit të mobilizimit përreth Gjirokastrës, është një projekt me Bankën Botërore. Do të ketë procedura, që besoj se do të zgjaten edhe pak, pasi fazat janë të tilla dhe duhet të përfundojë më së miri gjithë pjesa e ndërhyrjeve në qendër të qytetit. Gjithë këtë pjesë duhet ta finalizojmë sa më mirë. Nuk po them sa më shpejt, sepse siç e thashë edhe në fillim, është e rëndësishme të ecet me hapat e duhur.

Për sa i përket dypronësisë në godina, është një fenomen shumë i përhapur, jo vetëm në Gjirokastrë, por në të gjithë territorin. Është një plagë e bartur prej vitesh. Gjithmonë e më tepër, aty ku shikohet se ka një ndërveprim shtet-privat, aty ku ka një plan të qartë, sidomos në ndërhyrje të tilla të gjata në të gjithë qytetin, pra jo ndërhyrje pikësore, kemi vënë re që qasja po bëhet gjithmonë e më pozitive. Këto konflikte, deri diku, zgjidhen, pasi në largpamësinë për të shkuar drejt një finalizimi, drejt një të mire të përbashkët të shtetit dhe privatit, kam vënë re që elemente të ndryshme kanë favorizuar dialogun. Paketat fiskale, ndihmat për hapjen e bujtinave, për shembull, në fshatrat e ndryshëm, kanë sjellë një shtysë pozitive për të zgjidhur deri diku konfliktet në aspektin e pronësisë private.

Rikonstruksioni i “Kongresi i Lushnjës” është një projekt i vitit 2014. Ka qenë një bashkëpunim me bashkinë e Lushnjës.

Sigurisht, sa herë flitet për aktivitetet kulturore, për monumente kulture, aty ku është detyrë e menaxhimit të bashkisë, gjenden gjithmonë mënyrat e duhura të ndërveprimit. Me siguri do të ketë më shumë nevojë për bashkëpunime të tilla. Nuk është asnjëherë e lehtë të ndahen kufijtë e qartë, se ku fillojnë detyrimet dhe përgjegjësitë e një institucioni dhe ku mbarojnë të tjetrit, por për godina të tilla të rëndësishme kombëtare jam e bindur se ka shumë mundësi për të gjetur mënyrën e duhur të dialogut. Ne, si ministri, dhe Instituti i Monumenteve të Kulturës gjithmonë kemi pasur një qasje pozitive në hartimin e projekteve. Ministria ka ardhur gjithmonë në krah të çdo institucioni dhe të çdo privati për hartimin e projekteve, sidomos atyre të restaurimit.

Për sa u përket fshatrave, sidomos rasti i Bylisit, siç ju e cituat, është një nga projektet, për të cilin jemi duke marrë hapa konkretë për ta finalizuar dhe për ta financuar me partnerë të huaj, me BE-në. Pjesa e arkeologjisë është një tjetër element, për të cilin ka një vëmendje të shtuar jo vetëm nga ministria, por edhe nga shumë partnerë të huaj. Në të gjitha takimet që unë kam zhvilluar me partnerët dhe me donatorët e mundshëm, ka qenë një kërkesë kryesore jo vetëm ajo e rizbulimit dhe dokumentimit me ekspertë të huaj, por, mbi të gjitha, pjesa e mirëmbajtjes dhe e menaxhimit. Tashmë ne jemi në një fazë që e kemi të qartë se trashëgimia kulturore është një motor zhvillimi.

Për sa u përket *site*-ve arkeologjike, është shumë e rëndësishme që të kemi në fokus jo vetëm zbulimin e kësaj pjese kaq të larmishme dhe kaq me vlerë që ka vendi ynë, por, mbi të gjitha, t'i kemi të qarta detyrimet edhe me partnerët, që, në momentin që ata do të afrohen dhe do të bashkëpunojnë me ne, procesi i plotë do të jetë gjithmonë zbulimi, dokumentimi, mirëmbajtja dhe plani i menaxhimit. Vetëm në këtë mënyrë, vetëm nëse do t'i kemi të gjitha hallkat me partnerët, atëherë vërtet do të kemi kryer një bashkëpunim të mirëfilltë dhe do t'i kemi dhënë diçka vendit tonë. Nëse do të vazhdojmë të kemi vetëm grupe të vegjël ekspertësh, si dhe universitetet, të cilat do të bëjnë hulumtimet e tyre në njësi të vogla dhe, më pas, do të bëjmë rizbulimin, siç është e zakonshme që duhet të ndodhë, do t'i japim vetëm një vlerë shumë të vogël dhe momentale atij territori apo atij fshati ku ndodhen këto *site* arkeologjike. Pra, ky është fokusi ynë. Ndoshta në fillim do të arrijmë ta realizojmë këtë gjë në pak *site*, Bylysi është njëri prej tyre, dhe për këtë nëse do të kemi bashkëpunimin, do të kemi dëshirën dhe do të jemi vërtet në një linjë me partnerët tanë, atëherë do të ecim në këtë drejtim. Ne duam që, ashtu si edhe Butrinti, të gjitha *site*-t e tjera arkeologjike të kthehen në modele pilot, që më pas të lidhen edhe me njëri-tjetrin, në mënyrë që të krijohet një zinxhir i mirëfilltë dhe të gjitha të jenë të mirëmenaxhuara.

Gjithashtu, projekti për rrugën e aksesimit drejt Bylisit është miratuar dhe, së shpejti, besoj se do të futet në një nga programet e shumta që ka qeveria shqiptare, jo vetëm me financim të buxhetit të shtetit. Në këtë kuadër, si në aspektin për *site*-t arkeologjike, ashtu edhe në aspektin e projektit “100 fshatrat”, do të gjejnë më së miri ndërthurjen e shumë projekteve të tjera. Në rastin konkret qeveria ka një fond të dedikuar për projektin “100 fshatrat”, i cili për këtë vit është 1 miliard lekë. Ky fond do të shtrihet në të gjitha fshatrat, por nuk do të prekë infrastrukturën, sepse programe të tjera, që kanë lidhje me BE-në, me Bankën Botërore dhe me partnerë të tjerë të huaj, do të adresohen gjithmonë e më shumë në kompletimin e mëtejshëm të elementeve që do të na vijjnë në ndihmë për rijetësimin e këtyre fshatrave.

Kuptohet që këto ndërhyrje, të cilat do të kryhen në 100 fshatra, do të prekin edhe pjesën e trashëgimisë kulturore. Pjesa e projekteve të restaurimit ka filluar me kohë dhe ne jemi duke e vazhduar. Puna që është bërë deri në fund të vit 2018, ka qenë identifikimi i monumenteve të kulturës, ku përgjithësisht ato janë banesa dhe janë të pakta ato monumente të cilat mund të jenë pronë publike. Kështu që është punuar shumë për të identifikuar këto monumente, të cilat janë pothuajse të gatshme për t'u rikthyer në aktivitete ekonomike. Kjo është formula e prioritizimit të investimit në trashëgiminë kulturore nëpër fshatra. Në ato godina ku ne do të jemi më të sigurtë, do të kemi një mundësi investimi dhe kthimi në aktivitete ekonomike, ku ne të parët do të jemi të prirur për të kryer këtë investim.

Gjithashtu, folët për 75 - vjetorin e çlirimit të atdheut. Është e vërtetë që ne, si ministri, por edhe ministri të tjera, në kuadër të këtij përvjetori të madh, jemi angazhuar për të kryer aktivitete të ndryshme.

Ju përmendët varret e dëshmorëve, por kjo në të vërtetë është pjesë e menaxhimit bashkiak. Megjithatë, siç e thashë, asnjëherë nuk ka munguar ndërveprimi dhe mbështetja e forcave prej ministrisë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Për sa i përket pjesës së mirëmbajtjes së muzeve, të gjithë e dimë që pjesa më e rëndësishme e muzeve është pjesa e ripërtëritjes së përmbajtjes. Shumë prej muzeve tanë e kanë të nevojshme që të rikonceptohen, sepse kanë lindur në një konceptim muzeal të vjetër.

Tani për tani ne jemi të fokusuar në gjithçka që ka të bëjë me mirëmbajtjen e godinave dhe çdo gjë do të bëhet hap pas hapi, si në rastin e Muzeut Arkeologjik të Durrësit, ku në projektet kemi shtuar së fundi rikonceptimin e katit të fundit, një element i mbetur në harresë, i cili zë një nga hapësirat më me vlerë të këtij muzeu.

Për rikonceptimin e muzeve është e nevojshme të ndiqet një proces i gjatë, sepse nuk është aspak e lehtë, se do të sjellë joaksesimin e këtyre hapësirave. Kjo sigurisht që do të sjellë një moment tjetër pakënaqësish dhe do të rigjendemi duke ridiskutuar se cila do të jetë koha e duhur për të mbaruar. Gjithsesi, është një proces që duhet ndërmarrë dhe, përtej polemikave, është i nevojshëm. Nëse bëhet me energjinë dhe pozitivitetin e duhur, rezultatet do të jenë të dukshme.

Gjithashtu, ju më pyetët për pjesën e peizazhit në Gjirokastrë, nëse ka vëmendje për këtë pjesë. Është e vërtetë që nuk e citova në fjalën time, por po hartohet një plan kombëtar për peizazhin, sepse është një element që u bashkohet aspekteve të trashëgimisë kulturore të vendit tonë. Pra, peizazhi është pjesë e trashëgimisë kulturore. Është një element që ngjan pak sa abstrakt, por në Shqipëri është një elementet i çmuar dhe gjen motiv për të qenë i mbrojtur,

mjafton të përmendim që këtë vit Dita Botërore e Trashëgimisë Kulturore ishte për peizazhin kulturor.

Unë mendoj që duhet punuar shumë jo vetëm në hartimin e planit kombëtar për peizazhin, por edhe për sensibilizimin e çdo institucioni, që ta shikojë peizazhin si vlerë të trashëgimisë kulturore. Kemi raste konkrete, si liqenet e Ohrit, të Prespës dhe plot zona të tjera, që tashmë janë praktika drejt futjes në UNESCO. Për këtë duhet ta kemi të gjithë të qartë se vendi ynë mund të zhvillojë akoma më tepër aktivitetet ekonomike dhe të kemi të ardhura edhe prej asaj që natyra na ka dhuruar.

Të drejtat dhe detyrimet e pronarëve. Po, është e vërtetë që për pasuritë kulturore, të cilat u jepen deri diku në përdorim privatëve, pra pronarëve të këtyre godinave, ka disa aspekte që kanë të bëjnë me të drejtat që ata kanë, por edhe me detyrimet që ata duhet t'u përgjigjen. Ata kanë të drejtë të përfitojnë konsultime, ekspertiza, rekomandime dhe projektet e restaurimit. Pothuajse në çdo mbledhje të Këshillit Kombëtar të Restaurimit ne miratojmë projekte restaurimesh monumente culture, banesash private, të cilat hartohen nga drejtoritë tona rajonale. Ky është një proces që vazhdon sipas investimit, nëse do të jetë një investim shtetëror apo privat, sepse privatët shpeshherë duan të ndërmarrin rikualifikimin e banesës së tyre, dhe kjo ndiqet hap pas hapi, po njësoj, nga drejtoritë tona rajonale, nga Instituti i Monumenteve të Kulturës, me supervisorët, të cilët i caktojmë ne për t'i ndjekur këto punime, por që shkojnë edhe përtej vetëm konsulencës për restaurimin, shpeshherë edhe në rastet e aktiviteteve, si bujtina, restorante e të tjera. Ne jemi angazhuar deri në përcjelljen e elementeve tradicionale, pra deri diku edhe atje ku instituti apo supervisorët duhet ta kishin mbaruar punën e tyre, pasi bashkëveprimi ka qenë i tillë, duke u kthyer në një element të frytshëm.

Ata kanë të drejtën të aplikojnë për mbështetje financiare nëpërmjet skemave fiskale për grante. Në rastin konkret ne kemi projekte ose programe që financohen nga buxheti i shtetit, po ashtu edhe nga donatorë të huaj dhe jemi ne të parët, siç jua thashë edhe më parë, të prirur për t'i identifikuar ata banorë, të cilët do ta kthejnë shtëpinë e tyre në një hapësirë jo vetëm për jetesën e tyre të përditshme, por në të mirën e gjithë komunitetit, të turistëve, si dhe për aktivitete të ndryshme.

Nuk duhet harruar se ata kanë edhe detyrime, sepse posedojnë një pasuri kulturore jo vetëm private, por kombëtare dhe duhet të kujdesen për ta ruajtur dhe për ta mbajtur në gjendje të mirë, konstante, për të mos arritur në faza të tilla, në të cilat gjendemi tashmë, vite të tëra harrese, për të cilat më pas është investuar për t'i restauruar. Po flas për shifra shumë të mëdha, gjë që nuk do të kishte ndodhur nëse do të ishin ndërmarrë hapa të vegjël gjatë gjithë kohës.

Gjithashtu, ata duhet të informojnë institucionet e trashëgimisë kulturore, inspektoratin përgjegjës për trashëgiminë kulturore, njësitë e vetëqeverisjes për çdo dëmtim, për çdo zbulim apo për çdo veprim që parashikohet në ligj. Fatkeqësisht jo gjithmonë ky ndërveprim ka ndodhur, sepse shpeshherë shumë prej tyre mund t'i kenë abandonuar shtëpitë e tyre, siç po ndodh tashmë. Këto kohë kemi një rikthim në vendet e lindjes, duke parë edhe investimet që janë bërë atje, mjafton të flasim për rastin konkret në Gjirokastrë. Tashmë shumë prej banorëve të këtij qyteti po rikthehen të banojnë në shtëpitë e tyre, vetëm për faktin që është ndërmarrë një fushatë e tërë rikualifikimi, restaurimi, por edhe sensibilizimi për vlerat kulturore.

Gjithashtu, ata duhet të koordinohen për hartimin, miratimin e projekteve të ndërhyrjeve. Ky është një proces tjetër dhe ne kemi vënë të gjitha strukturat tona në dispozicion për këtë proces, vazhdojmë me fushatat sensibilizuese dhe ata nuk mundet të procedojnë me projekte restaurimi nëpërmjet profesionistëve jo të licencuar për pjesën e restaurimit, pasi të gjitha punimet duhet të supervizohen prej Institutit të Monumenteve.

Ata duhet të paraqesin dokumentacionet e nevojshme për të vënë në dispozicion pasurinë për verifikim, për mbështetjen e autoriteteve në ushtrimin e kompetencave, duhet të sigurojnë akses të lirë atje. Tashmë ato janë kthyer në godina, ku pas restaurimit do të aksesohen në mënyrë të lirë ose me pagesë edhe nga turistë të tjerë.

Gjithashtu, ka edhe forma të tjera që i parashikon ligji, por unë nuk do të doja t'i trembja me listën e gjatë, por është e vërtetë që ashtu siç kanë të drejta për pronën e tyre, ata kanë edhe detyrime. Në rast dëmtimi apo shkatërrimi të pasurisë kulturore për arsye të mospërbushjes së detyrimeve, pronarët dhe poseduesit e pasurisë kulturore duhet ta rivendosin atë në formën e saj origjinale, nëse është e mundur. Ky është një tjetër element, të cilit i duhet vënë theksi, pasi shpeshherë dëmtimet e kryera në godinat e tyre u kanë dhënë atyre të drejtën për ta rimenduar, sipas funksioneve më jetike, pa iu ripërshtatur tipologjisë ose formës origjinale.

Sa u takon *infopoint*-eve, është e vërtetë që në kalanë e Gjirokastrës së fundi është vendosur *infopoint*-i. Siç edhe jua thashë në fillim, Gjirokastra është një qytet muze në qiell të hapur, prandaj nuk mund flasim për një ose dy *infopoint*-e. Gjirokastra e ka me të vërtetë të nevojshme t'i lidhë këto pika, që secila të jetë një derë hyrëse në qytet. Për këtë jemi duke hartuar një projekt bashkë me Bankën Botërore, duke specifikuar se cili do të jetë rrjeti i muzeve që do të kalojnë përtej godinave, të cilat njihen dhe përtej kalasë, por edhe me shtimin e disa pikave të tjera për të krijuar zinxhirin e mirëfilltë muzeal, i cili do të ketë më pas edhe *infopoint*-et përshkruese ose tabelat gjatë itinerarit, me qëllim që të shkohet drejt aksesimit nëpërmjet internetit dhe aplikacioneve. Fokusi im në këtë muaj ka qenë shtimi i projekteve të

digjitalizimit dhe teknologjisë. Gjithashtu, nëpërmjet celularit do të mund të merret informacioni, duke u futur në *virtualtur*. Në fakt, ka vështirësi, por nëpërmjet *virtualtur*-eve dhe nëpërmjet informacioneve të këtyre itinerareve, ne do të mund të krijojmë edhe një *website* të dedikuar, që të jetë një promovim për Gjirokastrën. E shikoj pjesën e *infopointe*-ve si një aset të domosdoshëm, por me një qasje më të vjetër. Kemi mundësi të bëjmë më shumë se kaq.

Milva Ekonomi- Në lidhje me *infopoint*-et, a keni menduar për ndonjë shënim të vogël për bashkinë që, për shembull, nëse Pazari është mbyllur, të mund të shkohet në një drejtim tjetër?

Elva Margariti – Po, kemi një projekt shumë afatgjatë edhe kjo do të jetë një nga pikat e rëndësishme, siç do të jetë edhe informimi i turistëve.

Milva Ekonomi- A keni pyetje?

“Tirana intelektum”, na është drejtuar për dijeni me një shkresë që i është drejtuar Erion Veliajt për idenë e një muzeu për Tiranën. A keni dhënë ju ndonjë përgjigje, apo vetëm keni bashkëbiseduar me Bashkinë e Tiranës?

Elva Margariti – Po, ne jemi në fazën e bashkëbisedimit me Bashkinë e Tiranës. Kohët e fundit është shtruar ideja për të pasur muze edhe me tematika të ndryshme në qytete dhe fshatra, të cilën e shikojmë si një pozitivitet. Tashmë kemi filluar të sensibilizohemi që gjithçka që ka lidhje me kujtesën, është element që kemi mundësi të ndërveprojmë.

E shikoj me pozitivitet faktin që na vijnë informacione. Ministrinë janë parë si ideatorë jo vetëm për politikën dhe strategjinë, por edhe për projekte më të detajuara.

Konkretisht nuk i kemi kthyer përgjigje shoqatës, por mendoj se për të gjitha ato kërkesa, të cilat kanë nevojë për një bashkëveprim me shumë aktorë, për të mos kthyer përgjigjet klasike, do të ishte shumë më mirë të kishim takim të dedikuar, që të shkonim përtej shkresave, një bashkëbisedim dhe ngritje e grupeve të punës.

Milva Ekonomi - Ju falënderojmë shumë!

Rezervojmë të drejtën që sa herë do të kemi nevojë për t’u sqaruar më tej se si po shkon zbatimi i ligjit “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, t’ju thërrasim në dëgjuesë dhe, kur vëmë re shqetësime që vijnë nga publiku, të kemi një përgjigje të drejtpërdrejtë nga ju. Komisioni e ka këtë praktikë, e ka ndjekur edhe më parë.

Ju falënderojmë për këtë ardhje të parë dhe për prezantimin e gjerë që bëtë, dhe shpresojmë që në të ardhmen të kemi po këtë lloj bashkëpunimi, qoftë shkresor apo verbal, për të gjitha çështjet që lidhen me trashëgiminë kulturore apo me të tjera çështje të kulturës në Shqipëri.

Duam t'ju përgëzojmë, gjithashtu, se jemi vënë në dijeni që po bëni gati edhe kalendarin e festave, të cilin do ta lançoni së shpejti. Për ne deputetët ka qenë kënaqësi, kur kalendarin vinte përmes telefonave tanë apo ishte në *aps*-et që përdornim.

Ju faleminderit dhe punë të mbarë!

Elva Margariti - Faleminderit juve!

Sa i përket kalendarit, po, është e vërtetë! Në datën 3 do të kemi lançimin së bashku me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit. Gjithmonë kemi qenë dy ministritë, që kemi hartuar dhe zhvilluar këto aktivitete. Këtë vit, e them me plot gojën, shtohen edhe më tepër aktivitetet e trashëgimisë jomateriale. Është vërtetë e rëndësishme që të flasim, të ndërjegjësohemi; në asnjë aspekt tjetër nuk ka më mirë sesa festat locale, që të mund ta tregojmë gojëplotë të gjithë të bukurën që kemi.

Milva Ekonomi – Së pari, uroj të keni kaluar Pashkë të gëzuara dhe faleminderit, Adelinë, që na kujton me buzëqeshje gjithmonë!

(Diskutim pa mikrofon.)

Përpara kemi ligjin “Për Akademinë e Shkencave” dhe në datën 10 maj, të premtën, kemi dëgjuesën e parë, pastaj vazhdojmë punët me kalendarin tonë.

Dëgjesa e parë do të bëhet me shumë palë, me Ministrinë e Arsimit, me grupin nismëtar, me grupin e punës dhe me ne. Nuk bëheshin dot datat, ndaj u la data 10 maj, kështu që mos u shqetësoni që është e premtë.

Së dyti, kërkoj mbështetjen tuaj lidhur me këtë: nga data 10 maj e tutje të mundohemi që të gjitha dëgjuesat t'i bëjmë maksimumi të hënën, duke bërë disa mbledhje rresht dhe pastaj javën ta kemi në dispozicion të seancës dhe për aktivitetet në zonë. Kështu që edhe nëse të hënën do ta kemi të ngarkuar, që mund të zgjasë më shumë se ora 4, apo 5, pasi kemi një ligj për shqyrtim, do t'ju lutesha të kem mirëkuptimin e të gjithëve.

Ende nuk e kemi prezent kalendarin e dëgjësave; thamë të bëjmë dëgjuesën fillestare në datën 10, pastaj të vazhdojmë me gjërat e tjera. E di që secili prej jush do të lëvizë në data të ndryshme dhe këto data duhet të m'i thoni mua që, kur të kemi gati kalendarin, të shoh nëse do të kemi mundësi të bëjmë takimin apo jo, nëse plotësohet kuorumi.

Gjëja tjetër është ftesa që na ka bërë komisioni homolog i Kosovës. Ata na kanë thirrur në datat 14-15 maj. Kemi thënë se po të jetë e hënë, do të nisemi pas mbledhjes së grupit. Ka një problem, të cilin do ta zgjidhë menjëherë Muhameti, i cili ka qenë shumë komunikues me grupin kosovar për këtë gjë, por duhet të shkojmë edhe një herë te Kryetari i Kuvendit për konfirmimin definitiv. Është për datat 13-14 maj.

(Ndërrhyrje pa mikrofon.)

E hënë dhe e martë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Dakord. Ne bëhemi 7.

Problemi është të jemi 7 veta, që të na quhet takimi, pasi kështu ka kuptim.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Kemi konfirmuar me ata. E kemi dërguar disa herë datën.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Dakord.

Ne duhet ta konfirmojmë përfundimisht, pasi të pyesim edhe një herë Kryetarin e Kuvendit.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po.

Na takimet që kemi bërë me OSBE-në, në përgjithësi ne i kemi ftuar zëvendësuesit dhe ata që janë deputetë të zonave. Këtë radhë nuk u bë me shkrim kjo gjë, por nëpërmjet mesazheve. Unë do të ftoj sekretarinë ta ketë parasysh këtë gjë, që sa herë që kemi takime jashtë, të vërë në dijeni edhe zëvendësuesit dhe deputetët e zonave. Në Korçë ne i lajmëruam të tri deputetët e zonës.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk kishin mundësi, sepse kishin axhendën e tyre.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Dakord!

Ju lutem, nëse keni ndonjë gjë për procesverbalet, përpiquni t'ia kaloni Arianës në mënyrë individuale. Kam bindjen se Ariana i kontrollon shumë mirë procesverbalet, siç kam bindjen që Muhameti i mban shumë mirë kontaktet relacionale që ka komisioni me homologët e vet në Kosovë, Maqedoni dhe ku kemi punuar.

Atëherë e mbyllim këtu mbledhjen për sot.

MBYLLET MBLEDHJA